



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .11.2022

MBLEDHJA Nr. 50,
Datë 07.11.2022, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 07.11.2022, ora 16:45**, do të zhvillohet mbledhja nr. 50 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 01.11.2022
2. Mbi procedurën e nisur me vendimin nr. 188, datë 21.07.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku Energji” sh.p.k.
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s n. 150, datë 10.06.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI